


KUJTIME QË S'HARROHEN NGA NXËNËSIT GJATË EKSKURSIONIT BUZË LIQENIT TË OHRIT



Nxënësit e kl.IX-1 fotografuar në një nga urat përgjatë lumit Drini i Zi në Strugë (Foto: M. S.)



*Strugë, pamje e shëtitores përgjatë Drinit të Zi
(Foto: Gafur Demiri)*



*Strugë, Ura e parë prej druri mbi lumin Drini i Zi në
dalje të liqenit të Ohrit (Foto: Mujdin Sulejmani)*

Më 22 maj 2025 u realizua ekskursioni njëditor me nxënësit e ciklit të lartë të SHF “Rilindja” të Sellcës dhe asaj periferike të Vicës në liqenin e Ohrit. Aktiviteti u organizua si pjesë e programit edukativ dhe kulturor të shkollës, me synimin për t’i njohur nxënësit nga afër me vlerat natyrore dhe trashëgiminë kulturore të rajonit të Strugës dhe Ohrit

Ekskursioni nisi në orën 07:00 të mëngjesit dhe përfundoi rreth orës 20:30. Nxënësit, të shoqëruar nga mësuesit kujdestarë dhe stafi pedagogjik, vizituan qytetin e Strugës dhe shëtitorën përgjatë liqenit të Ohrit dhe lumit Drini i Zi. Gjatë vizitës nxënësit u njohën me vlerat natyrore, historike, artistike dhe mjedisore të rajonit.

Ekskursioni pati ndikim pozitiv në zhvillimin edukativ, kulturor dhe social të nxënësve. Gjatë gjithë aktivitetit nxënësit treguan disiplinë, interes dhe respekt ndaj rregullave të përcaktuara. Ekskursioni u realizua me sukses dhe pa ndonjë incident. Të gjithë pjesëmarrësit u kthyen të sigurt në destinacionin fillestar.

Ky aktivitet shërbeu si një përvojë e vlefshme dhe motivuese për nxënësit, duke forcuar edhe më tej bashkëpunimin dhe frymën kolektive.

Raportin e përgatiti:

Mujdin Sulejmani, arsimtar i gjuhës shqipe

Data: 22 maj 2025